

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-733/2021	Data: Datum: 30.11.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), shqyrtoi kërkesën e datës 30.11.2021 të Drejtorisë për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim, për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për ndarjen e druve-zjarri për raste në nevojë, nxjerr:

V E N D I M

- Formohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për ndarjen e druve-zjarri për raste në nevojë dhe në komision caktohen:
 - Skender Hasangjekaj**, Udhëheqës i Sektorit për Mbrojtje dhe Shpëtim Kryesues i komisionit;
 - Xhevat Idrizaj**, Zyrtar për Pylltari, anëtar;
 - Blerim Bujupi**, Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar;
- Komisioni i cekur me lartë ka për obligim që të bëjë shqyrtimin e të gjitha kërkesave për ndarjen e druve për ngrohje për raste në nevojë; komisioni obligohet të bëjë hartimin e listës dhe të njoftojë Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.
- Përgjegjësin për shqyrtimin e kërkesave për ndarjen e druve-zjarri për raste në nevojë e merr Komisioni
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe Drejtoria për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim.
- Vendimi është përfundimtarë.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave, Drejtoria për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-732/021	Data: Datum: 26.11.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formim të komisionit për verifikimin e punëve për projektet: Lot1 “Asfaltimi i rrugës në Studenicë deri te varrezat”; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-6010-5-2-1/C511 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-21-050-521; Lot3 “Asfaltimi i rrugës Dobrushë-Lubovë”; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-5821-5-2-1/C522 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-21-048-521 dhe nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për verifikimin e punëve për projektet: Lot1 “Asfaltimi i rrugës në Studenicë deri te varrezat”; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-6010-5-2-1/C511 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-21-050-521; Lot3 “Asfaltimi i rrugës Dobrushë-Lubovë”; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-5821-5-2-1/C522 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-21-048-521/C511 të cilat projekte i ka realizuar operatori “**SHKEMBI**” SH.P.K dhe në komision caktohen:

- 1.1. Dukagjin Hoxhaj,** Zyrtar për Regjistrimin e Adresave, Kryesues i Komisionit,
- 1.2. Abedin Neziraj,** Zyrtar për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komuniteteve, anëtar dhe;
- 1.3. Besnik Metaj,** Zyrtar për Tatim në Pronë, anëtar .

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projekteve të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftoj kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj menaxheret e projekteve dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejt të menaxhereve të projekteve, do të njoftoj Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur; do të hartojë procesverbalin për pranimin teknik të projektit si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni

3. Përgjegjësin për pranimin e punëve për projektet e lartcekura e merr Komisioni.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim .

5. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Komisioni, Prokurimi, operatori “SHKEMBI” SH.P.K** Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	Nr.Br. 01-731/2021	Data: Datum: 26.11.2021	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës, bazuar në nënin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 25.11.2021, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Furnizimi me Lende Djegese Dru”, nxjerr:

V E N D I M

- 1. ÇAKTOHET:** Menaxhere e kontratës Zize Bujupaj, Udhëheqës e Sektorit në Drejtorin e Arsimit dhe **ÇAKTOHET:** Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës **Hajrush Shoshi**, Drejtor i D.K.A dhe Menaxher i kontrates Kamer Berisha, Mirmbajtes në Q.K.M.F dhe Mbikqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontrates **Muje Osmanaj** Drejtore në D.SH.M.S për projektin: “Furnizimi me Lende Djegese Dru”, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-8152-1-1-1 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-021-063-111, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar Grupi i operatorve ekonomik; “**SHOSHANI**” SH.P.K & N.T“**CHARLY**”
- Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
- Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.
- Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: **Zize Bujupaj, Hajrush Shoshi, Kamer Berisha, Muje Osmanaj**, Grupi i operatorve ekonomik “**SHOSHANI**” SH.P.K & N.T“**CHARLY**” dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-730/021	Data: Datum: 26.11.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, bazuar në Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të lidhur në mes të komunës dhe OJQ “Vision 02” t datës 08.08.2019, shqyrtoi kërkesën se bashku me projekt-propozimin Nr.01-400-47731 të datës 02.11.2021 të parashtruar nga OJQ “Vision 02” të cilën e përfaqëson Rexhë Mulaj për përkrahje financiare, nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-400-47731 e datës 02.11.2021 e parashtruar nga OJQ “Vision 02” të cilën e përfaqëson Rexhë Mulaj për përkrahje financiare dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **300.00€ (treqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Administratë Komunale-kodi për barazi gjinore, për realizimin e punëtorisë: “BuidingCapacityforInclusiveEducation-INLCUDE”.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e OJQ-së “Vision 02” në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Administratë Komunale
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

OJQ “Vision 02” ka parashtruar kërkesën Nr.01-400-47731 të datës 02.11.2021, për përkrahje financiare për realizimin e punëtorisë: “BuidingCapacityforInclusiveEducation-INLCUDE”.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e OJQ “Vision 02” dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

OJQ “Vision 02” ka kërkuar mjete financiare në shumë prej **2,014.00€**, por në mungesë të mjeteve financiare përkrahet financiarisht në shumë prej **300.00€** për shkak të rëndësisë së realizimin e punëtorisë së cekur me lartë sipas projekt-propozimit.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Administratë Komunale është-kodi për barazi gjinore përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t’i transferohen në xhirollogarinë e OJQ “Vision 02”, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

Për sa u theksua me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të Vendimit njoftohen: OJQ “Vision 02”, Drejtoria për Administratë Komunale dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01.Nr. <u>729</u> /021	Data: <u>26</u> .11.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 67 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë Komunale të Arsimit 05.Nr.768/2021 të datës 26.11.2021, për kompensimin në lartësi prej 3 (tri) pagave mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Hamdi Kabashi, me titull të postit: Mësimdhënës i mësimit klasor në SHFMU "Bajram Curri" në Istog, dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa 05.Nr.768/2021 e datës 26.11.2021, e parashtruar nga Drejtoria Komunale e Arsimit për kompensimin në lartësi prej 3 (tri) pagave mujore që i ka marr për tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Hamdi Kabashi, me titull të postit: Mësimdhënës i mësimit klasor në SHFMU "Bajram Curri" në Istog.
2. Mësimdhënësit të lartpërmendur i përfundon shërbimi me 14.12.2021.
3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.
4. Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime në Drejtorinë për Arsim, obligohet që Hamdi Kabashi, t'ia bëjë pagesën, e 3 (tri) pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve komunale të administratës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Hamdi Kabashi, Drejtoria Komunale e Arsimit, Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe kompensime dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA


 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-727/021	Data: Datum: 25.11.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim shqyrtoj kërkesën Nr.08-553-50367-të datës 17.11.2021 të parashtruar nga Adnan Bicaj, nga Vrellë, Komuna e Istogut dhe me kërkesën e datës 30.11.2021 DSHPMSh i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.08-553-50367 e datës 17.11.2021 e parashtruar nga Adnan Bicaj, për kompenzimin e dëmit të shkaktuar nga rrëshqitja e dheut dhe rrëzimi i murit mbrojtës afër mullirit në Vrellë e që një person ka vdekur, nga kjo ka filluar të dëmtohet edhe shtëpia dhe i ndahen 2,500.00€ (dy mijë e pesëqind euro) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Adnan Bicaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Adnan Bicaj ka parashtruar kërkesën Nr.08-553-50367 të datës 17.11.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga rrëshqitja e dheut dhe rrëzimi i murit mbrojtës afër mullirit në Vrellë e që një person ka gjetur vdekur nga kjo, ka filluar të dëmtohet edhe shtëpia e që familja prej shtatë anëtareve janë evokuar tek të afërmit e tij.

Kryetari shqyrtoi propozimin e Komisionit për vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga rrëshqitja e dheut dhe rrëzimi i murit mbrojtës dhe të njëjtin e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Komisioni ka dalur në vendin e ngjarjes ka vlerësuar dëmin e shkaktuar dhe ka dal me vlerësimin e dëmit të shkaktuar dhe perkrahet mjete financiare në shumë prej 2,500.00€ (dy mijë e pesëqind euro).

Nga shkresat e lendes shihet se ka rrëshqitur dheu është rrezuar murit mbrojtës dhe një person ka gjetë vdekjen ku ka filluar të dëmtohet edhe shtëpia e banimit dhe paraqet rrezik.

I lartëpërmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomiko sociale dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë ndërtimin e shtëpisë.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për perkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit të njoftohen; Adnan Bicaj, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 726 /2021	Data: Datum: 25.11.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nën 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.01-553-50615, të datës 19.11.2021, e parashtruar nga z.Gëzim Ademaj, nga fsh. Lubovë, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e bashkëshortes së tij, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.01-553-50615, të datës 19.11.2021, e parashtruar nga z.Gëzim Ademaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim të bashkëshortes, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 600€(gjashtëqindë euro), nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Gëzim Ademaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Gëzim Ademaj, ka parashtruar kërkesën Nr.01-553-47737, të datës 19.11.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërimin e bashkëshortes. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se znj. Luljeta Ademaj, është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim. Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim. Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Gëzim Ademaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike. Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen z.Gëzim Ademaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-725/021	Data: Datum: 24.11.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 22, paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenin 22, paragrafi 2 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj kërkesën Nr.01-120-51079 të datës 23.11.2021, e parashtruar nga **(Ermiona Ahmetaj)** nga Vitomerica për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së prindit-babës i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-120-51079 e datës 23.11.2021 e parashtruar nga **Ermiona Ahmetaj**, Inspektore Sanitare, për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së babës **(Agim Ahmetaj)** dhe i ndahen mjetet financiare në shumën prej **389.20€** (treqind e tetëdhjete e nëntë euro e njëzet cent) nga programi buxhetor i Drejtorisë për Inspeksion, kategoria ekonomike paga dhe mëditje kodi ekonomik 11155-shtesat dhe kompensimet tjera (vendim) si ndihmë për familjen e të lartpërmendurës.
2. Mjetet e cekura në piken 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e **Ermiona Ahmetaj**, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij të kujdeset: Drejtoria për Inspeksione dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Ermiona Ahmetaj**, Drejtoria për Inspeksione, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Z. Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01.724/021	Data: Datum: 24.11.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në bazë të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR)-Nr.02/2020 për masat dhe kriteret e përkrahjes për zhvillim rural për vitin 2020-2021 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi shqyrtoj kërkesën Nr.09-320-8983 të datës 09.03.2021 të parashtruar nga Qazim Blakaj nga fsh. Kovragë, Komuna e Istogut për kompensimin e subvencionimit dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 09-320-8983 e datës Nr.09.03.2021 e parashtruar nga Qazim Blakaj nga fsh. Kovragë, për kompensimin për subvencionim dhe me propozimi të D.B.P.H përkrahet vetëm sipas Udhëzimit Administrativ (MBPZHR)-Nr.02/2020 dhe jo pjesën kompensimit sipas Vendimit të Qeveri dhe i ndahen majtët financiare në shumë prej **1,860.00€ (njëmijë e tetëqind e gjashtëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Qazim Blakaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Qazim Blakaj, ka parashtruar kërkesë Nr.09-320-8983 e datës 09.03.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për kompensimin e subvencioneve.

Kryetari shqyrtoi propozimin e Drejtorisë për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi për kompensimin e subvencioneve të fermerit Qazim Blakaj dhe të njëjtin e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi ka shqyrtuar lenden dhe ka konstatuar se në Sektorin e Bujqësisë është bërë gabim teknik në sistemin e aplikimit gjatë aplikimit për subvencione në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për sipërfaqet e tokës të mbjellë me molla, e që fermeri ka qenë përfitues i subvencioneve që nga viti 2015 e me radhë deri në vitin 2020. Bazuar në situatën e krijuar me covid 19 nga zyrtari është harruar futja e të dhënave në sistem, dhe fermeri është mbete jashtë sistemit për vitin 2020 për arsyeje krejt teknike për shkak të volumit të madhe të punëve dhe për këtë arsye kompensohet fermeri për subvencion në shumë prej **1,860.00€ (njëmijë e tetëqind e gjashtëdhjetë euro)** vetëm siç është paraparë me Udhëzimit Administrativ (MBPZHR)-Nr.02/2020 e jo edhe sipas Vendimit të Qeverisë për dyfishimin e subvencioneve, i cili me të ardhurat e veta nuk mund të siguroj plehra dhe pesticide për trajtimin e mollëve se ato mjete nga MBPZHR janë të dedikuara për fermer vetëm për këtë qëllim.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje financiare për kompensimin e subvencioneve.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit të njoftohen Qazim Blakaj, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Drejtori i DBPH
z.Lulzim SHOSHI



Kryetari i Komunës
z. Haki RUGOVA




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-723/2021	Data: Datum: 24.11.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësimin e dëmit i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, shqyrtoi kërkesën Nr.08-320-50968 të datës 23.11.2021, të parashtruar nga Esad Smakić, nga fsh. Dobrushë, Komuna e Istogut, për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri dhe i propozon Kryetarit me shkresë të datës 24.11.2021 të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.08-320-50968 e datës 23.11.2021 e parashtruar nga Esad Smakić, për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri është shkaktuar zjarri nga pakujdesia e që ju kanë djegur drutë dhe i ndahen **810€ (tetëqind e dhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyra Komunale për Komunitet dhe Kthim.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Esad Smakić, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Esad Smakić, ka parashtruar kërkesën Nr.08-320-50968 të datës 23.11.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri respektivisht është shkaktuar zjarri nga pakujdesia e që ju kanë djegur drutë.

Kryetari shqyrtoi propozimin e Komisionit për vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri dhe të njëjtin e konsideron te arsyeshme dhe e miraton.

Komisioni ka ndaluar në vendin e ngjarjes dhe me procesverbal ka vlerësuar dëmin e shkaktuar nga zjarri nga pakujdesia e që ju kanë djegur drutë 9m³ në shumë prej **810€ (tetëqind e dhjetë euro)**

Nga shkresat e lendes shihet se Esadit ju kanë djegur drutë nga zjarri i shkaktuar dhe i cili nuk është në gjendje që me mjetet e tij vetanake ti blejë drutë dhe për këtë arsye i ndihmohet me mjete financiare.

Në planin e programit buxhetor të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit të njoftohen: Esad Smakić, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-722/021	Data: Datum: 24.11.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e datës 24.11.2021 të parashtruar nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, për përkrahje të familjeve në nevojë-skamnor me pako ushqimore dhe pako higjienike dhe i propozojë Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim e datës 24.11.2021, për përkrahje të familjeve në nevojë-skamnor me pako ushqimore ndahet shuma prej **2,110.00€ (dymijë e njëqind e dhjetë euro)**, për pako higjienike ndahet shuma prej **1,000.00€ (njëmijë euro)**, nga kodi ekonomik mallra dhe shërbime të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, për furnizim me material ushqimore në shumë prej **2,110.00€ (dymijë e njëqind e dhjetë euro)**, do të transferohen në xhirollogarinë e operatorit ekonomik "Flortenti" market; për furnizim me material higjienik në shumë prej **1,000.00€ (njëmijë euro)** do të transferohen në xhirollogarinë e operatorit ekonomik Bujar Kastrati B.I "Deni", në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
4. Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: "Florenti", Bujar Kastrati B.I "Deni", Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-721/2021	Data: Datum: 24.11.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 24.11.2021 për formimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin "Furnizimi dhe Instalimi i Nxemjes Qendrore në SHMU "Martin Camaj"-Gurakoc; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-8327-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-067-121, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: "Furnizimi dhe Instalimi i Nxemjes Qendrore në SHMU "Martin Camaj"-Gurakoc"; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-8327-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-067-121 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Isa Hoxhaj,** Inxh. i Elektroteknikës, Zyrtar i Lartë për Eficiencë të Energjisë, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Mimoza Osmanaj,** Drejtoreshë SHMU "Martin Camaj" në Gurakoc, anëtare dhe
- 1.3. Naim Sadriu,** Zyrtar për Standarde, Monitorim dhe Vlersim, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: "Furnizimi dhe Instalimi i Nxemjes Qendrore në SHMU "Martin Camaj"-Gurakoc"; me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

5. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor brenda 24 orëve të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit të kenë qasje në ofertat e operatorëve ekonomik që kanë shprehur konkurrencë.

6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria Komunale për Arsim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria Komunale për Arsim, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- <u>718</u> /021	Data: Datum: <u>23</u> .11.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58. pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L 040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe në Ligjin për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032, Drejtoria për Arsim shqyrtoi kërkesën 05.Nr.400-49992 të datës 15.11.2021 të parashtruar nga Blerina Osmanaj nga Istogu studente në Universitetin e Prishtinës-Fakultetin e Shkencave Matematik-Natyrore e cila ka kërkuar mbështetje financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për në shtetin e Suedisë pasi që e njëjta deklaron se është pranuar në një program studimor në Universitetin e Umea-s dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 05.Nr.400-49992 e datës 15.11.2021, e parashtruar nga Blerina Osmanaj studente në Universitetin e Prishtinës-Fakultetin e Shkencave Matematik-Natyrore e cila ka kërkuar mbështetje financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për në shtetin e Suedisë pasi që e njëjta deklaron se është pranuar në një program studimor në Universitetin e Umea-s dhe i ndahen 300 € (treqind euro) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale të Arsimit.
2. Pagesa e mjeteve të cekura, do të bëhet nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe të njëjtat do të transferohen në xhirollogarinë e Blerina Osmanaj në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria Komunale e Arsimit.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Blerina Osmanaj nga Istogu ka parashtruar kërkesën 05.Nr.400-49992 të datës 15.11.2021, me të cilën kërkesë ka kërkuar mbështetje financiare nga Drejtoria Komunale e Arsimit për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për në shtetin e Suedisë pasi që e njëjta deklaron se është pranuar në një program studimor në Universitetin e Umea-s ku kostoja e udhëtimit nuk është e përfshirë e që një kosto e tillë për studentën është e pa përballueshme.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendures dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Arsim është përcaktuar edhe kodi ekonomik i subvencioneve dhe transverëve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore, shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë të shoqatave joqeveritare dhe individëve.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogari e Blerina Osmanaj nga nëpunësi përgjegjës në Drejtorinë për Arsim në pajtim me procedurat në fuqi.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Blerina Osmanaj ,Drejtoria Komunale e Arsimit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-<u>717</u>/021	Data: Datum: <u>23</u> .11.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58. pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L 040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe në Ligjin për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032, Drejtoria për Arsim shqyrtoi kërkesën 05.Nr.400-49994 të datës 15.11.2021 të parashtruar nga Lorenden Hysenaj nga Istogu student në Universitetin e Prishtinës-Fakultetin e Shkencave Matematik-Natyrore i cili ka kërkuar mbështetje financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për në shtetin e Suedisë pasi që i njëjti deklaron së është pranuar në një program studimor në Universitetin e Umea-s dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 05.Nr.400-49994 e datës 15.11.2021, e parashtruar nga Lorenden Hysenaj student në Universitetin e Prishtinës-Fakultetin e Shkencave Matematik-Natyrore i cili ka kërkuar mbështetje financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për në shtetin e Suedisë pasi që i njëjti deklaron së është pranuar në një program studimor në Universitetin e Umea-s dhe i ndahen 300 € (treqind euro) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale të Arsimit.
2. Pagesa e mjeteve të cekura, do të bëhet nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe të njëjtat do të transferohen në xhirollogarinë e Lorenden Hysenaj në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria Komunale e Arsimit.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Lorenden Hysenaj nga Istogu ka parashtruar kërkesën 05.Nr.400-49994 të datës 15.11.2021, me të cilën kërkesë ka kërkuar mbështetje financiare nga Drejtoria Komunale e Arsimit për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për në shtetin e Suedisë pasi që i njëjti deklaron së është pranuar në një program studimor në Universitetin e Umea-s ku kostoja e udhëtimit nuk është e përfshirë e që një kosto e tillë për studentin është e pa përballueshme.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Arsim është përcaktuar edhe kodi ekonomik i subvencioneve dhe transverëve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore, shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë të shoqatave joqeveritare dhe individëve.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogari e Lorenden Hysenaj nga nëpunësi përgjegjës në Drejtorinë për Arsim në pajtim me procedurat në fuqi.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen; Lorenden Hysenaj ,Drejtoria Komunale e Arsimit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 7/6/021	Data: Datum: 22.11.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-17119, të datës, 18.05.2021 e parashtruar nga z.Remzi Quni, nga fsh.Serbobran, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-17119, të datës 18.05.2021, e parashtruar z.Remzi Quni , për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Remzi Quni, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra komunale për komunitete dhe kthim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Remzi Quni, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-17119, të datës 18.05.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim te tij.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Remzi Quni, është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës komunale kthim dhe komunitete, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Remzi Quni, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: z.Remzi Quni, Zyra komunale për komunitete dhe kthim, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-715/2021	Data: Datum: 19.11.2021	

Kryetari i Komünës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 17.11.2021, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Mirëmbajta e Adresave”; nxjerr:

V E N D I M

- 1. CAKTOHET:** Menaxher i kontratës **Dukagjin Hoxhaj**, Zyrtar për Regjistrim të Adresave në Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mjedis dhe **CAKTOHET:** Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës **Rrustem Gashi**, U.D. i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis për projektin: “Mirëmbajta e Adresave”, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-3805-1-3-6/C519 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-021-028-136, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori dhe **“SINJALIZIMI” SH.P.K. nga fsh. Vraniq komuna e Suharekës.**
- Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
- Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë.
- Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: **Dukagjin Hoxhaj, Rrustem Gashi**, operatori **“SINJALIZIMI” SH.P.K.** dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit:


Zyrtari Kryesor Administrativ
z.Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-714 /021	Data: Datum: 19.11.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-50555, të datës 19.11.2021 të parashtruar nga z.Muhamet Maraj nga fsh.Vrellë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e bashkeshortes së tij në QKUK -Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-50555, të datës 19.11.2021 e parashtruar nga z.Muhamet Maraj, për përkrahje me karburant për dërgimin e bashkeshortes së tij në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore(Kimioterapisë), dhe i lejohen 250 litra karburant.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që, z.Muhamet Maraj të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Muhamet Maraj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-50555, të datës 19.11.2021 , me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i tij për dializë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se znj.Luljeta Metaj-Maraj, është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e tij për dializë . I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij për dializë.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmenduren më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi. Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: z.Muhamet Maraj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-713/021	Data: Datum: 19.11.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit për formim të komisionit për verifikimin e punëve për projektin: Lot1 “Renovimi i DysHEMEVE në Gjumnazin “Haxhi Zeka”; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-3716-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-027-521 nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për verifikimin e punëve për projektin: Lot1 “Renovimi i DysHEMEVE në Gjumnazin “Haxhi Zeka”; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-3716-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-027-521 të cilin e ka realizuar operatori NNT “Loshi-Design” nga Istogu dhe në komision caktohen:

- 1.1. Blerim Bujupi,** Zyrtar për Ndërtimtari, Kryesues i Komisionit,
- 1.2. Hekuran Rugova,** Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, anëtar dhe;
- 1.3. Brahim Bytyqi,** Drejtorë në Gjumnazin “Haxhi Zeka”, anëtar .

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftojë menaxheret e projektit dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejt të menaxhereve të projektit; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur; do të hartojë procesverbalin për pranimin teknik të projektit si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për pranimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria Komunale e Arsimit.

5. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Komisioni, Prokurimi, Drejtoria Komunale e Arsimit, operatori NNT “Loshi-Design”** dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-712/021	Data: Datum: 19.11.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), për formim të komisionit për verifikimin e punëve për projektin: “Ndërtimi i objekteve për Institucionet e nivelit Parashkollor (Qerdhe e Fëmijëve) Vrellë-projekt 2 vjeçar 2020-2021 Bashkëfinancim nga MASHT dhe Komuna Istogut”; me numër të jashtëm prokurimi 633-20-4734-5-2-1/C407 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-020-063-521 dhe Anex kontrata për projektin: “Ndërtimi i objekteve për Institucionet e nivelit Parashkollor (Qerdhe e Fëmijëve) Vrellë-projekt 2 vjeçar 2020-2021-punë shtesë”; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-5772-5-2-1/C407 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-047-521 nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për verifikimin e punëve për projektin: Ndërtimi i objekteve për Institucionet e nivelit Parashkollor (Qerdhe e Fëmijëve) Vrellë-projekt 2 vjeçar 2020-2021 Bashkëfinancim nga MASHT dhe Komuna Istogut”; me numër të jashtëm prokurimi 633-20-4734-5-2-1/C407 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-20-063-521 dhe Anex kontrata për projektin: “Ndërtimi i objekteve për Institucionet e nivelit Parashkollor (Qerdhe e Fëmijëve) Vrellë-projekt 2 vjeçar 2020-2021-punë shtesë”; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-5772-5-2-1/C407 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-047-521 të cilin e ka realizuar operatori NNP “CTA” SH.P.K & NNP “EUROING” SH.P.K nga Prishtina, përkatësisht Rahoveci, të cilën e përfaqëson z. Zija Morina dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Rexhep Blakaj**, Ing. I Arkitekturës-Udhëheqës i Sektorit për Urbanizëm, Kryesues i Komisionit,
- 1.2. **Isa Hoxhaj**, Ing. i Makinerisë-Zyrtar i Lartë për Eficiencë të Energjisë, anëtar dhe;
- 1.3. **Zize Bujupaj** Udhëheqës i Sektorit për Arsim, anëtare .

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve për kontratën kryesore dhe aneks kontratën; do të njoftojë menaxherin e projektit dhe mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të menaxherit të projektit, do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur; do të hartojë procesverbalin për pranimin teknik të projektit si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për pranimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria Komunale e Arsimit.

5. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Komisioni, Prokurimi, Drejtoria Komunale e Arsimit, operatori NNP “CTA” SH.P.K & NNP “EUROING” SH.P.K** dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-711/021	Data: Datum: 18.11.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 22, paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenin 22, paragrafi 2 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj kërkesën Nr.01-120-49910 të datës 15.11.2021, e parashtruar nga **Shahe Visoqi** nga Istogu për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së prindit-nënës (**Zejna Gashi**) i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-120-49910 e datës 15.11.2021 e parashtruar nga **Shahe Visoqi**, Zyrtare për Buxhet dhe Financa, për pagesën e shpenzimeve të varrimit me rastin e vdekjes së nënës (**Zejna Gashi**) dhe i ndahen mjetet financiare në shumën prej **389.20 €** (treqind e tetëdhjetë e nëntë euro e njëzet cent) nga programi buxhetor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, kategoria ekonomike paga dhe mëditje kodi ekonomik 11155-shtesat dhe kompensimet tjera (vendim) si ndihmë për familjen e të lartpërmendurës.
2. Mjetet e cekura në piken 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e **Shahe Visoqi**, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësië.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Shahe Visoqi**, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
z.Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-710/021	Data: Datum: 18.11.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formim të komisionit për Rifformatim të punëve të kontratës për projektin: “Asfaltimi i Rugës Livadhet e Istogut-Mokna faza e parë (I)- projekt 3 vjeçar”; me numër të jashtëm prokurimi 633-20-5287-5-1-1/C444, sipas Vendimit Nr.01-709/2021 të datës 17.11.2021 nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për Rifformatim të punëve sipas kontratës për projektin: “Asfaltimi i Rugës Livadhet e Istogut-Mokna faza e parë (I)- projekt 3 vjeçar”; me numër të jashtëm prokurimi 633-20-5287-5-1-1/C444, të cilin është duke e realizuar “**SHKEMBI**”**SH.P.K** dhe në komision caktohen:

- 1.1. Hekuran Rugova,** Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, Kryesues i Komisionit,
- 1.2. Blerim Bujupi,** Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar dhe;
- 1.3. Përfaqësuesi i Ministrisë së Infrastrukturës,** anëtar .

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe Rifformatimin e kontratës për punimet e projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj menaxherin e projektit dhe mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të menaxherit të projektit, do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur; do të hartojë procesverbalin për Rifformatim të kontratës si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e komisionit të tillë.

3. Përgjegjësin për Rifformatim të punëve sipas kontratës për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim .

5. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Komisioni, Prokurimi, Operatori “SHKEMBI” SH.P.K, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim** dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-709/021	Data: Datum: 17.11.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e organit mbikëqyrës "P.M.N" SH.P.K të datës 22.09.2021, për Riformatimin e punëve sipas kontratës për projektin: "Asfaltimi i Rugës Livadhet e Istogut-Mokna faza e parë (I)- projekt 3 vjeçar"; me numër të jashtëm prokurimi 633-20-5287-5-1-1/C444, nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa e organit mbikëqyrës "P.M.N" SH.P.K të datës 22.09.2021, për Riformatimin e punëve sipas kontratës për projektin: "Asfaltimi i Rugës Livadhet e Istogut-Mokna faza e parë (I)- projekt 3 vjeçar"; me numër të jashtëm prokurimi 633-20-5287-5-1-1/C444.
- Për Riformatimin e punëve sipas kontratës për projektin e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi duhet të themelohet komisioni i cili do të bëjë riformimin e kontratës.
- Përgjegjësin për Riformatim të punëve sipas kontratës për projektin e lartcekur e merr Komisioni.
- Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim .
- Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Komisioni, Prokurimi, Operatori "SHKEMBI" SH.P.K, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim** dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Z. Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-708/2021	Data: Datum: 17.11.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit për formimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin “Asfaltimi i Rruges në Lagjen Demiraj ne Shushicë”; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-8439-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-069-521, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Asfaltimi i Rruges në Lagjen Demiraj ne Shushicë”; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-8439-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-069-521 dhe në komision caktohen:

1.1. Naser Gjoci, Udhëheqës i Sektorit për Shërbimeve Publike, Kryesues i Komisionit;

1.2. Hekuran Rugova, Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve , anëtar dhe

1.3. Blerim Bujupi, Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: “Asfaltimi i Rruges në Lagjen Demiraj ne Shushicë”; me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

5. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor brenda 24 orëve të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit të kenë qasje në ofertat e operatorëve ekonomik qe kanë shprehur konkurrencë.

6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-707/021	Data: Datum: 17.11.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e datës 17.11.2021 të parashtruar nga OJQ Syriivizionit me seli në Pejë, për caktimin e anëtarit të komisionit nga komuna e Istogut për vlerësimin e Grandeve të vogla për realizimin e projektit “Fuqizimi dhe punësimi i të rinjve, grave dhe grupeve tjera në nevojë, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa e datës 17.11.2021 e parashtruar nga OJQ Syriivizionit me seli në Pejë, për caktimin e anëtarit të komisionit nga komuna e Istogut për vlerësimin e Grandeve të vogla për realizimin e projektit “Fuqizimi dhe punësimi i të rinjeve, grave dhe grupeve tjera në nevojë.
2. Caktohet Genc Ademaj, Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Projekteve për partneritet publiko-privat, anëtar i Komisionit vlerësues të Grandeve të vogla të OJQ Syriivizionit.
2. Obligohet Genc Ademaj të merr pjesë në komisionin e lartcekur dhe të bashkëpunoj me OJQ Syriivizionit.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Genc Ademaj dhe OJQ Syriivizionit.
5. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendim do të njoftohen: Genc Ademaj, OJQ Syriivizionit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Z. Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-706/021	Data: Datum: 17.11.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) shqyrtoj kërkesën e datës 11.11.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Prokurimit për zotimin e mjeteve financiare për projektet e financuara nga komuniteti në bashkëpunim me komunën nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa e datës 11.11.2021 të parashtruar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Prokurimit për zotimin e mjeteve financiare për projektet e financuara nga komuniteti në bashkëpunim me komunën për projektet: “Asfaltimi i rrugës-lagja Mehaj dhe vendosja e ndriçimit publik” shuma prej 12,263.75€; “Ndërtimi i rrugës lagja Kurtaj” shuma prej 1,200.00€; “Asfaltimi i rrugës lagja Kajtažaj” shuma prej 1,800.00€; “Asfaltimi i rrugës lagja Alijaj Uçë” shuma 745,00€.

2. Zyrtari zotues obligohet ti zotoj mjetet financiare si në pikën 1 të këtij Vendimi.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendim do të njoftohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-705/021	Data: Datum: 17.11.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-38938, të datës, 14.09.2021 e parashtruar nga z.Nexhmedin Madanaj, nga fsh.Staradran, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e vajzës se tij, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-38938, të datës 14.09.2021, e parashtruar, z.Nexhmedin Madanaj j, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim te vajzës, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Nexhmedin Madanaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiive.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra komunale për komunitete dhe kthim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Nexhmedin Madanaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-38938, të datës 14.09.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim te vajzës se tij.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Albina Madanaj, është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës komunale kthim dhe komunitete, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësiive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Nexhmedin Madanaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: z.Nexhmedin Madanaj, Zyra komunale për komunitete dhe kthim, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-704/021	Data: Datum: 17.11.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-16265, të datës, 11.05.2021 e parashtruar nga znj.Bahrije Hoti, nga fsh.Uçë, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e saj, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-16265, të datës 11.05.2021, e parashtruar znj.Bahrije Hoti, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e znj.Bahrije Hoti, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra komunale për komunitete dhe kthim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

znj.Bahrije Hoti, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-16265, të datës 11.05.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim te saj.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se znj.Bahrije Hoti, është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme. E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës komunale kthim dhe komunitete, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e znj.Bahrije Hoti, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: znj.Bahrije Hoti, Zyra komunale për komunitete dhe kthim, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	Nr.Br. 01-703/021	Data: Datum: 16.11.2021	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formim të komisionit për verifikimin e punëve për projektet: Lot3 "Betonimi i kanalit Dobrushë Lubovë"; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-1265-5-2-1/454 Lot4 "Rregullimi i përroit vërshues Kaliqan" me numër të jashtëm prokurimi 633-21-1265-5-2-1/454 Lot1 "Betonimi i kanalit të ujitjes në Dubovë"; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-1265-5-2-1/455 Lot1 "Betonimi i kanalit të ujitjes të Lubeniqeve-Tomoc (projekt 2 vjeçar)"; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-2395-5-2-1/C473 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-21-019-521 Lot4 "Betonimi i kanalit në Lagjen Gjocaj-Tomoc"; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-2395-5-2-1/C476 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-21-019-521/C476 Lot2 "Betonimi i kanalit të ri Lagja Bujupaj-Demiraj"; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-2395-5-2-1/474 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-21-019-521 Lot3 "Betonimi i kanalit në Llukavc të Begut"; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-2395-5-2-1/475 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-21-019-521 dhe nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për verifikimin e punëve për projektet: Lot3 "Betonimi i kanalit Dobrushë Lubovë"; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-1265-5-2-1/454 Lot4 "Rregullimi i përroit vërshues Kaliqan" me numër të jashtëm prokurimi 633-21-1265-5-2-1/454 të cilin e ka realizuar Grup i operatorëve "LURN" SH.P.K; ENGINEERING GROUP SH.P.K, Rr Abedin Sogojeva, Fushë Kosovë Lot1 "Betonimi i kanalit të ujitjes në Dubovë"; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-1265-5-2-1/455 të cilin e ka realizuar operatori "AXIS G.C.W." SH.P.K Lot1 "Betonimi i kanalit të ujitjes të Lubeniqeve-Tomoc (projekt 2 vjeçar)"; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-2395-5-2-1/C473 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-21-019-521 të cilin e ka realizuar operatori "MENTI" SH.P.K Lot4 "Betonimi i kanalit në Lagjen Gjocaj-Tomoc"; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-2395-5-2-1/C476 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-21-019-521/C476 të cilin e ka realizuar operatori SHTEPIA G. "SH.P.K" Lot2 "Betonimi i kanalit të ri Lagja Bujupaj-Demiraj"; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-2395-5-2-1/474 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-21-019-521 të cilin e ka realizuar operatori Grup i operatorëve "LURN" SH.P.K; Pro&CO Group SH.P.K; Lot3 "Betonimi i kanalit në Llukavc të Begut"; me numër të jashtëm prokurimi 633-21-2395-5-2-1/475 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-21-019-521 të cilin e ka realizuar Grup i Operatorëve Ekonomik "FILATI" SH.P.K.; BK-CONSTRUCTION SH.P.K dhe në komision caktohen:

- 1.1. Blerim Bujupi, Zyrtar për Ndërtimtari, Kryesues i Komisionit,
- 1.2. Valbone Kaliqanaj, Zyrtare e Lartë për Pemtari, anëtare dhe;
- 1.3. Jeton Sylaj, Zyrtar për pagesa me subvencione, anëtar .

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projekteve të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftoj kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj menaxheret e projekteve dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejt të menaxhereve të projekteve, do të njoftoj Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur; do të hartoj procesverbalin për pranimin teknik të projektit si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e komisionit të tillë.

3. Përgjegjësin për pranimin e punëve për projektet e lartcekura e merr Komisioni.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidrekonomi..

5. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, operatorët "LURN" SH.P.K; ENGINEERING GROUP SH.P.K; "AXIS G.C.W." SH.P.K; "MENTI" SH.P.K; SHTEPIA G. "SH.P.K"; "LURN" SH.P.K; Pro&CO Group SH.P.K; "FILATI" SH.P.K.; BK-CONSTRUCTION SH.P.K Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidrekonomi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-702/2021	Data: Datum: 16.11.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit për formimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Furnizim me pajisjet sportive për institucionet shkollore”; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-8446-1-3-6 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-068-136, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: Furnizim me pajisjet sportive për institucionet shkollore”; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-8446-1-3-6 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-068-136, dhe në komision caktohen:

- 1.1. Labinot Metaj,** Arsimitar i Edukatës Fizike në SHFMU në “Bajram Curri” në Istog, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Florije Bytyçi,** Zyrtare për Arsimin e Mesëm të Ulët, anëtare dhe
- 1.3. Arton Haxhijaj,** Arsimitar i Edukatës Fizike në SHFMU në ”Hysni Zajmi” në Vrellë; anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: “Furnizim me pajisjet sportive për institucionet shkollore” me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

5. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor brenda 24 orëve të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit të kenë qasje në ofertat e operatorëve ekonomik që kanë shprehur konkurrencë.

6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria Komunale e Arsimit.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
z.Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 701 /021	Data: Datum: 16.11.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58. pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L 040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe në Ligjin për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032, Drejtoria për Arsim shqyrtoi kërkesën Nr.05-553-14115 të datës 22.04.2021 të parashtruar nga Ajet Zeqiraj nga fsh. Kërrninë, Komuna e Istogut, për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për fëmijën e tij i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.05-553-14115 e datës 22.04.2021, e parashtruar nga Ajet Zeqiraj për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për fëmijët e tij dhe i ndahen 150€ (njëqind e pesëdhjetë euro) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim si ndihmë momentale për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2021/22, relacioni Kërrninë – Gurakoc dhe anasjelltas.
2. Pagesa e mjeteve të cekura, do të bëhet nga Drejtoria për Arsim dhe të njëjtat do të transferohen në xhirollogarinë e babait Ajet Zeqiraj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Ajet Zeqiraj, ka parashtruar kërkesë Nr.05-553-14115 të datës 22.04.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për pagimin e shpenzimeve të udhëtimit për fëmijët e tij si nxënës të rregullt në SHMLP "Mithat Frashri" në Gurakoc për gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2021. z.Ajet e ka gjendjen e vështir ekonomike nuk ka asnjë burim të rregull të të ardhurave dhe kështu nuk ka mundësi me ja mbuluar shpenzimet e udhëtimit për fëmijën e tij. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Arsim është përcaktuar edhe kodi ekonomik i subvencioneve dhe transverëve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore, shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë të shoqatave joqeveritare dhe individëve. Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Ajet Zeqiraj, nga nëpunësi përgjegjës në Drejtorinë për Arsim në pajtim me procedurat në fuqi. Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Ajet Zeqiraj, Drejtorin për Arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-700/021	Data: Datum: 16.11.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58. pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L 040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe në Ligjin për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032, Drejtoria për Arsim shqyrtoi kërkesën Nr.05-553-47126 të datës 29.10.2021 të parashtruar nga Musa Maxharraj nga fsh. Vrellë Komuna e Istogut, për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për fëmijën e tij i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.05-553-47126 e datës 29.10.2021, e parashtruar nga Musa Maxharraj për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për fëmijën e tij dhe i ndahen 150€ (njëqind e pesdhjet euro) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim si ndihmë momentale për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2021/22, relacioni Vrellë – Pejë dhe anasjelltas.
2. Pagesa e mjeteve të cekura, do të bëhet nga Drejtoria për Arsim dhe të njëjtat do të transferohen në xhirollogarinë e babait Musa Maxharraj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Musa Maxharraj, ka parashtruar kërkesë Nr.05-553-47126 të datës 29.10.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për pagimin e shpenzimeve të udhëtimit për fëmijën e tij si nxënës të rregullt në SHML "Haxhi Zeka" në Pejë për gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2021. Z.Musa e ka gjendjen e vështir ekonomike nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kështu nuk ka mundësi me ja mbuluar shpenzimet e udhëtimit për fëmijët e tij. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Arsim është përcaktuar edhe kodi ekonomik i subvencioneve dhe transverëve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore, shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë të shoqatave joqeveritare dhe individëve.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Musa Maxharraj, nga nëpunësi përgjegjës në Drejtorinë për Arsim në pajtim me procedurat në fuqi.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Musa Maxharraj, Drejtorin për Arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës,
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-69/021	Data: Datum: 16.11.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58. pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L 040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe në Ligjin për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032, Drejtoria për Arsim shqyrtoi kërkesën Nr.05-553-48655 të datës 05.11.2021 të parashtruar nga Lirim Arifaj nga fsh. Banjë Komuna e Istogut, për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit ,për femiun e tij i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.05-553-48655 e datës 05.11.2021, e parashtruar nga Lirim Arifaj për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për femiun e tij dhe i ndahen 160€ (njëqind e gjashtëdhjet euro) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim si ndihmë momentale për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2021/22, relacioni Banjë – Istog dhe anasjelltas.
2. Pagesa e mjeteve të cekura, do të bëhet nga Drejtoria për Arsim dhe të njëjtat do të transferohen në xhirollogarinë e babait Lirim Arifaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Lirim Arifaj, ka parashtruar kërkesë Nr.05-553-48655 të datës 05.11.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për pagimin e shpenzimeve të udhëtimit për femiun e tij si nxënës të rregullt në SHML "Haxhi Zeka" në Istog për gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2021. Z.Lirim e ka gjendjen e vështir ekonomike nuk ka asnjë burim të rregull të të ardhurave dhe kështu nuk ka mundësi me ja mbuluar shpenzimet e udhëtimit për femiun e tij. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Në planin e programit buxhetor të Drejtorisë për Arsim është përcaktuar edhe kodi ekonomik i subvencioneve dhe transverëve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore, shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë të shoqatave joqeveritare dhe individëve. Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogari të Lirim Arifaj, nga nëpunësi përgjegjës në Drejtorinë për Arsim në pajtim me procedurat në fuqi. Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Lirim Arifaj, Drejtorin për Arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës,
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- <u>698</u> /021	Data: Datum: <u>16.11.2021</u>	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13. dhe 58. pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L 040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe në Ligjin për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032, Drejtoria për Arsim shqyrtoi kërkesën Nr.05-553-7606 të datës 01.03.2021 të parashtruar nga Enver Haskaj nga fsh. Cërrcë, Komuna e Istogut, për ofrim të ndihmës financiare për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për fëmijët e tij i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

